



PROCESVERBAL 5/2024

I Mbajtur në takimin e V- të të rregulltë të KPF-së me datën **27.05.2024**, në sallën e vogël të takimeve në ora 10⁰⁰ nën kryesimin e Kryesuesit të KPF-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtarës për informim.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. z. Xhavit Zariqi, Kryesues;
2. z. Arian Imeri, Anëtar
3. znj. Lumnije Morina, Anëtare;
4. znj. Mimoza Pajaziti, Anëtare;
5. z. Lulzim Abazi, Anëtar;
6. z. Brahim Osmani, Anëtar;
7. znj. Shqipe Jashari, Anëtare;
8. znj. Hatixhe Bungu Qerimi, Anëtare;
9. z. Flamur Istrefi, Anëtar dhe

Drejtorët e drejtorive;

1. z. Sabri Murseli - Drejtori i Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë
2. znj. Xhemile Murati Shabani - Drejtore e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe
3. z. Arbër Bytyqi - Drejtori i Urbanizmit dhe Mjedisit

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Përshëndetje të pranishëm, anëtarë të kuvendit, shoqëria civile, Drejtor të drejtorive, pra po fillojmë me mbledhjen e V-të të rregullt të KPF-së, besoi që materialin e keni marr me kohë dhe ju dëshiroi mirëseardhje në mbledhjen e KPF-së dhe propozojë këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së;
4. Propozim – Vendim për vënie në Diskutim publik të Draft - Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Draft-Plani i Veprimit për Rinin 2024-2027;

5. Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të QKMF-së në Koshare;
6. Propozim – Vendim për këmbimin e ngastrave kadastrale 1243-0, 1244-0 dhe 1245-3 Z.K. Sojevë, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 295-1 Z.K. Fshat i Vjetër, pronë e Komunës së Ferizajt;
7. Propozim – Vendim për këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale; 467-2 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 469-0 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt;
8. Propozim – Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit me Nr.01.Nr.111 të datës 31.08.2022;
9. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 3206-0 Z.K. Ferizaj, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 489-16 Z.K. Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt;
10. Propozim – Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrës kadastrale 710-0 Z.K. Bibaj, me sipërfaqe prej 6 m², KEDS-SH.A.
11. Propozim – Vendim për aprovimin e kërkesave për blerjen e banesave për të cilat ekziston e drejta e parablerjes;
12. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale; 692-4, 694-2, 693-3 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 1178-0 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt;
13. Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 963-1 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 7-0 Z.K. Muhoc, pronë e Komunës së Ferizajt;
14. Propozim – Vendim për vazhdimin e mandatit të Komisionit për Emërtimin e Rrugëve, Rrugicave dhe Shesheve për kompletimin e sistemit të adresave komunale dhe
15. Të ndryshme.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – A ka dikush rreth rendit të ditës?

Sabri Murseli – Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sot i kisha propozua edhe dy pika të reja të rendit të ditës;

1. Propozim - Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të Zaskokut, lokacioni për ndërtimin e objektit në Fshatin Zaskok caktohet në parcelën kadastrale 955-0 Z.K. me sipërfaqe prej 5 ari (500 m²), pronë e komunës e cila do të shërbej për të pame të Komunitetit të Zaskokut, ndërtimi dhe financimi do të bëhet nga banorët e Fshatit Zaskok.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Caktimi i objektit, për të pame të Komunitetit të Fshatit Zaskok.

Sabri Murseli – Po për të pame për nevoja të Komunitetit të Fshatit Zaskok dhe pika e dytë shtëse;

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Tjetra.

2. Propozim - Vendim për plotesim ndryshimin e Vendimit me Nr. 01.Nr. 2863 të datës 30.11.2005, mes të cilit është ba ndarja – destinimi i ngastrës kadastrale 180-10 Z.K. Talinoc i Jerlive për Lapidarin e Dëshmorit “Driton Islami”, kërkesa e familjes ka qenë të zgjerohet rrethoja brenda atij parku, komplet 15 ari që në të ardhmen mund të bëhet ndonjë ndryshim, 15 ari bëhet me park dhe bahet komplet qysh duhet për lapidarin me park të dëshmorit nga 3 ari në 15.20 ari e 20 m² (1520 m²).

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Pra i kemi dy propozime;

1. Propozim - Vendim për caktimin e lokacionit për ndertimin e objektit për nevoja të banorëve të Zaskokut;
2. Propozim - Vendim për plotesim ndryshimin e Vendimit me Nr. 01.Nr. 2863 të datës 30.11.2005, për zgjerimin e rrethojës komplet 15 ari që të bëhet me parkë lapidari i Dëshmorit “Driton Islami”. Kërkesa e familjes.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – A ka dikush tjetër

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – A ishit për këtë rend dite; kush është për; 9 vota për, faleminderit, a ka kundër 0, abstenim 0, vazhdojmë me rendin e ditës.

Pika 14

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Fillojmë me propozimin e Drejtorit; Propozim – Vendim për vazhdimin e mandatit të Komisionit për Emërtimin e Rrugëve, Rrugicave dhe Shesheve për kompletimin e sistemit të adresave komunale është pika e 14, drejtor a po na sqaron edhe një herë lidhur me këtë pikë?

Arbër Bytyqi – Sistemi i rrugëve dhe Adresat janë një kohë të gjatë që janë evidentuar dhe janë në fazën e fundit edhe për vendosjen në sistem dhe vendosjen në teren dhe është e domosdoshme që ta kem një komision që është kërku që të kem një staf më shumë të angazhuar për vendosjen e numrave në teren dhe për këtë arsye përveç Komisionit që ka qenë ma herët kemi propozu që edhe dy zyrtarë të rinjë të jenë Astrit Musliu dhe Artin Jashari si zyrtarë i të dhënave në teren për shkak që procesi i vendosjes së numrave në teren është proces i gjërë dhe kompania që e ka fituar tenderin për vendosjen e numrave ka kërkuar që të kem më shumë zyrtar në teren, që në mënyrë ky proces të shkojë në mënyrën më të mirë të mundshëm dhe të përmbyllet i tëri d.m.th edhe në teren edhe në sistemin e adresave, unë kam propozuar që ky komision të jetë në këtë përbërje, po ashtu për shkak të kërkesës të kuvendit kjo pikë që ka qenë para dy muajve në Kuvend të Komunës në Ferizaj dhe është ndryshuar edhe koordinatori për shkak që është edhe anëtarë i kuvendit nuk paguhet me kompensim mujor, por paguhet në bazë të mbledhjeve që bahen pra me meditje, jemi konsultu edhe me zyrën ligjore dhe gjithshka është në rregullë, Faleminderit.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Drejtor, a dëshiron dikush tjetër të diskutoi?

Brahim Osmani – Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë, uroi që të jetë një punë një vjeçare dhe të përfundoi sa më shpejt, këto pengesa që janë kriju po prap kompensimi i koordinatorit nuk është në rregullë dhe mendoi që Zyra ligjore u kanë dashtë me sqaru, se na në Zyre ligjore nuk jemi dhe është kanë mirë me këqyrë se asnjë komision nuk ashtë pagu me 50€ dhe të paktën çdo komision të paguhet 180€ sipas Ligjit të pagave, është mirë të reagohe prapë kur të vjenë në kuvend dhe të rregullohet dhe të përfundoi sa më shpejtë.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Brahimi, dikush tjetër?

Flamur Istrefi – Në bazë të asaj që kemi diskutuar në seancën e kaluar, për këtë pikë është prur një vendim, një opinion nga Zyra ligjore, po e shoh që se kemi edhe mendoi se puna e kompensimit që është dashtë dhe se nuk është në rregullë shuma 50€, veç është dashtë të ceket sa njerëz kanë drejtë me i majt, nuk është në rregullë tash me i majt, janë të parapamë në bazë të ligjit dhe nuk është në rregull me i paguar 500€, tjetra është diskutabile që e kemi pas herën e kalume, personi që punon në “Bifurkacion”, të lutem tash nëse këto mbledhje mbahen, në cilin vend do të mbahen, është shumë komfuze kjo, duhet me i ba zgjidhje, nuk jemi kundër asnjë personi këtu, nuk do të merremi me asnjë person, por jemi kundër ndaj një dokumenti që të formojmë një ekip, që të mirret për këtë punë me letra dhe në aspektin ligjor, nuk duhet me na ik e të themi se ja kapërcyem kësaj radhe, unë jam kundër për këtë, Faleminderit.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Urdhëro Shqipe.

Shqipe Jashari – Faleminderit Kryesues, Qysh e tha pak më herët Flamuri, na edhe në mbledhjen e kalueme kemi fol nëse është me orar të plotë 500€, duhet me i pas me orar të plotë, personi po punon në dy vende të punës dhe qysh është e mundshme kjo, me punu me orar të plotë, e tash ka kompensim, e tash nëse nuk punon me orar të plotë duhet të paguhet vetëm mëditja, e jo 500€ pagë mujore për një person që i ka dy vende të punës, që as ligji i pagave nuk e lejon, dy paga edhe sa herë kanë me u mbajtur këto mbledhje dhe në kuvend kanë me raportuar për sa herë kanë mbajtur mbledhje, të paktën çdo muaj, të paktën ta dimë për këtë komision që është me vite e vite, atëherë ta bëjnë që çdo muaj ta kemi një raport, ose çdo tre muaj, deri sa është periudha e punës këtij mandati, Faleminderit .

Arian Imeri – Te diskutimi i kolegut na po shofim se me një far forme rreth kësaj pune gjithmonë po dëshirojmë me ekzistua një komision edhe realisht me afat që ekziston në Zyrën ligjore, nuk e di me një far forme ose me një vendim ose diçka tjetër ose me email, e ku ta di unë brenda një objekti, po me ekzistu, kisha thanë me procedu në kuvend edhe pastaj në kuvend edhe drejtori nashta deri në kuvend na bjenë njëfarë informacioni shtesë edhe po e zgjedhim prap në kuvend

problemin e kompenzimit të Faikut edhe lidhur me mandatin e komisionit për kompensim, personi që punon dikund tjetër dhe këtu dhe mbasi e plotësojmë me të gjithë që është e nevojshme, ne e zgjedhim, Faleminderit .

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Arian, dikush tjetër, si po duket nuk ka dikush tjetër me zgjidhë këtë problem dhe se komisioni duhet të vazhdoi të funksionalizohet kjo çështje, po duket se është çështje diskutabile që personi punon dikund tjetër dhe që duhet të angazhohet në komision, kam biseduar edhe me drejtorin, nuk ka njeri tjetër që të gjindet në programin e sistemit që e ka e komisioni të funksionalizohet, respektivisht vetëm të zgjidhet dhe të vazhdoi me punën që ka dhe ky proces duhet të finalizohet, është e pa mundur të organizohet sa mbledhje janë mbajtur dhe ata duhet me punue non stop për me i fut të dhënat në sistem, nuk është punë caktimi sa mbledhje edhe sa mbledhje janë për pagesë d.m.th është çështja shumë e ndërlikueme e kompensimit realisht, nuk di si me zgjidh, nuk është punë me përcaktimin e mbledhjeve ose mu kanë ashtu duhet me marr vendime, por ai nuk ka me marr vendime, ka me i futur të dhënat në sistem pra duhet me punue vazhdimisht d.m.th. e jo me mbajtur mbledhje, por nëse ju pajtoheni ne e procedojmë për kuvend dhe deri në kuvend me na ardhë me një propozim konkret se si të funksionojë, por nuk guxojmë dhe nuk jemi të prirur me blloku këtë punën e sistemit, unë mendojë që duhet ta procedojmë për kuvend dhe ta sqarojmë me pak telashe, e nëse jo ta shofim.

Arbër Bytyqi - Na e biseduam edhe ma herët Kryesues, nuk janë mbledh për emra, po është problemi se është proces shumë i ndishëm edhe ka zgjat shumë, ish kanë mirë me e i dhanë drejtim, tash Premtimit i mbetet për me raportu për punën që e kryenë, me i raportu, qysh e zgjedhë dhe se vendi ku punon është çështje tjetër, pasi që ai duhet me zgjedhë dhe me na tregu neve.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Mënyra ma e mirë është që ta procesojmë në kuvend.

Arbër Bytyqi - Unë jam i hapur edhe për emra edhe për propozime çfarëdo që të jenë, ta kenë anëtarët e kuvendit, për ne është mirë me u vazhdu si proces, për shkak që procesi është shumë i rëndësishëm, edhe duhet me u përmbyll për shkak që presioni ashtë tu shku më gjatë.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Kush është për të kaluar pika e 14-të; 6 vota për, faleminderit, a ka kundër 0, abstenim 0, pra kalon për kuvend, vazhdojmë me pikën e 3-të të rendin e ditës.

Pika 3

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Po vazhdojmë me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar, a ka dikush të diskutoi për procesverbalin e mbledhjes së kaluar, nuk ka, kush është për miratimin procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së?, 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e 4-të,

Pika 4

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për vënie në Diskutim publik të Draft - Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Draft-Plani i Veprimit për Rinin 2024-2027, a ka dikush të diskutoi rreth kësaj pike, urdhëro Drejtore.

Xhemile Murati Shabani – Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë anëtarët e KPF-së, Drejtor, media shoqëri civile dhe të gjithë të pranishmit, pasi kisha dokumentin nga Draft Strategjia për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt për periudhën 2024-2029 dhe Draft-Plani i Veprimit për Rinin 2024-2027 që është një dokument i cili është hartuar nga një grup punues që ka për qëllim fuqizimin e të rinjve në periudhën 2024-2027 në komunën e Ferizajt duke e përfshirë të gjithë ata që janë pjesë e shoqërisë aktive edhe janë pjesëmarrës të procesit vendimmarrës, ky dokument është përkrah dhe financuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA, po ashtu është mbështetur nga Abasada e SHBA-së dhe implementohet nga KUSA, sa i përket Strategjisë për Fillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt, ndërsa sa i përket Planit të veprimit është projekt i cili është mbështetur në kuadër të Planit të veprimit të komunës për të rinjtë e cila mbështetet nga Qeveria Japoneze dhe po ashtu administrohet nga banka botërore dhe implementohet dhe mbështetet nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe me Komunën e Ferizajt, paraprakisht është formuar një grup punues i cili ka punuar rreth hartimit të këtij dokumenti dhe po ashtu janë kontaktuar edhe grupet tjera të interesit që konkretisht kanë të bëjnë me çështjet rinore dhe që ka për qëllim fuqizimin e të rinjve në proceset vendimmarrës, ky dokument është përgatitur dhe shpresojë që ta merr dritën jeshile dhe që ta përgatisë për seancën e kuvendit, ku është hapur për të dhënë votime të ndryshme si nga anëtarët e KPF-së, po ashtu edhe nga anëtarët e kuvendit të komunës, gjithashtu nëse ka dëgjim publik mund të mirren edhe propozime tjera, sepse ky dokument është servuar komplet qysh ka punuar grupi punues, Faleminderit .

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Drejtore, a dëshiron dikush të diskutoi apo po e kalojmë në kuvend, që është për diskutim publik dhe që ka kohë të vie me propozime, ndryshime, vrejte dhe sygjerime, a jeni që të kaloi kjo pikë, kush është për?, faleminderit, 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e 5-të.

Pika 5

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të QKMF-së në Koshare, kush është këtu që na sygjeron, urdhëro Drejtor.

Sabri Murseli – Faleminderit kryesues, ky Propozim – Vendim ka qëllim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të QKMF-së në Koshare, lokacioni është caktu në bazë të kërkesës së Kryetarit të fshatit, e i njëjti ka sjellë edhe disa peticione, mirëpo për këtë çështje është mirë me kërkuar opinionin për ta procesu në kuvend, mbasi po vjen nga Kosharja, nëse janë dakort. Me Amirin i patëm disa dilema, a është e duhur apo nuk është e duhur, është mirë që të dy të deklarojnë në kuvend, se a është ai lokacion në Koshare, apo nuk është dhe të vazhdojmë më tutje, Faleminderit , pra ta kemi parasysh se objekti do të ndërtohet me të hyra vetanake me buxhet tonin, Faleminderit .

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Drejtor a ka diçka diskutabile, mos ka qenë një lokacion i caktum me destinim prej komunës për diçka tjetër.

Sabri Murseli – Me sa di Kryesues të premtën Amiri më njoftoi se në ballin ka qenë e destinume për lapidar mos gabofsha dhe me Amirin e diskutuam që në kuvend të marrim një vendim, a është ky apo me vazhdua me një parcelë aty afër, që është pronë e komunës, që nuk prish punë.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Dëgjo drejtor, nëse është një vendim që nga buxheti i komunës është nda për ndërtimin e lapidarit, pa e anulë atë vendim me marr vendim tjetër, nuk mundemi me ndru atë lokacion, e dyta është pak e ndishme se ka të bajë me familje të dëshmorit, e nuk ka kuptim kjo, unë e kam një informatë që është një vendim, që është për ndërtimin e një lapidari dhe nëse është kështu na nuk guxojmë me i marr dy vendime, po është mirë me e sqaru në kuvend.

Sabri Murseli – Po kryesues për kuvend e sqaroi gjithqysh.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit , a ka dikush që dëshiron me diskutu, jo; kush është për; 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon për kuvend, vazhdojmë me pikën e 6-të.

Pika 6

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për këmbimin e ngastrave kadastrale 1243-0, 1244-0 dhe 1245-3 Z.K. Sojevë, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 295-1 Z.K. Fshat i Vjetër, pronë e Komunës së Ferizajt, urdhëro drejtor.

Sabri Murseli – Kryesues, ky Propozim – Vendim ka të bëjë për këmbimin e këtyre ngastrave kadastrale 1243-0, 1244-0 dhe 1245-3 Z.K. Sojevë, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 295-1 Z.K. Fshat i Vjetër, pronë e Komunës së Ferizajt, këto ngastra kadastrale janë shpall interes i përgjithshëm të këmbimit të pronave, është ba vlerësimi i pronave nga komuna, është vlerësu 9 euro e 9 cent për m² ndërsa pronën private parcela 1243-0, 13 euro për m² 1244-0, 16 euro për m² dhe 1245-3, 18.50 cent për m² që i bie te tri parcelat në sipërfaqe 83.96 m² pronë e Komunës së Ferizajt qysh na ka pru gjeodeti, mos gabofsha 50-60 ari.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Cili ka qenë interesi i komunës.

Sabri Murseli – Kryesues, zgjerimi i varrezave në fshatin Sojevë, një pjesë është për kyçje, është edhe një pjesë rruge gjerë te varrezat të Fshatit Sojevë, Faleminderit kryesues.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – A ka dikush tjetër të diskutoi, si duket nuk ka a jeni që të kaloi në kuvend kjo pikë e rendit të ditës, 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon për kuvend, vazhdojmë me pikën e 7-të.

Pika 7

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për këmbimin e pjesëve të ngastrave kadastrale; 467-2 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë private, me pjesën e ngastrës kadastrale 469-0 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt, Drejtor.

Sabri Murseli – Faleminderit Kryesues edhe ky Propozim – Vendim ka të bëjë me këmbim, paraprakisht është shpall interes i përgjithshëm kjo pjesë e parcelës me qëllim të vendimit të parcelave është bërë vlerësimi, kështu që 30 euro e kemi m² të dy pronave edhe i komunës sepse ka punë zhvendosje, sipërfaqja për këmbim është 3 ari e 16 m² për zhvendosjen e pjesës anësore, Faleminderit .

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Drejtor, a ka dikush tjetër të diskutoi, apo të kaloi në kuvend pika e 7-të; 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon për kuvend, vazhdojmë me pikën e 8-të.

Pika 8

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Vazhdojmë me Propozim – Vendimin për plotësim ndryshimin e vendimit me Nr.01.Nr.111 të datës 31.08.2022, urdhëro drejtor.

Sabri Murseli – Faleminderit Kryesues, ky Propozim – Vendimin ka të bëjë me plotësim ndryshimin e vendimit vetëm sa i përket sipërfaqes sepse vendimi paraprak është shpallë në tërësi në sipërfaqe prej 5 ari, objekti të “Stacioni i autobusëve” për shkak edhe të rregullimit të parcelave, po nuk po mundemi me thanë që 100% është interes i komunës, ku komuna siguron një objekt që mund ta lëshon me qira në të ardhmen, ka qenë sipërfaqe prej 5 ari, mirëpo pjesa që vrehet prej “Driton Islamit” pronari ka kërkuar të kompenzohet dhe që vërehet që është kompensu, e njëjta ashtë, është kompenzu dhe është ba coptimi, është 3 ari e 42 së bashku me objekt dhe të këmbëhet me pjesën anësore aty mbrapa, për këtë çështje jemi marr vesh me “Stacionin e autobusëve” ku kjo kërkesë është në vendimin e parë që është kry, Faleminderit .

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Drejtor, a dëshiron dikush të diskutoi, urdhëro.

Arian Imeri - Me ndryshime kjo shkon apo me vlerësim, pra vlerësimi hala nuk është ba?

Sabri Murseli – Po me ndryshim, në momentin që është kërku të zbatohet e kemi kry vlerësimin e mandej kemi vazhduar më tutje.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Drejtor, a dëshiron dikush tjetër?, nuk ka, a jeni që të kaloi në kuvend pika e 8-të; 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon për kuvend, vazhdojmë me pikën e 9-të.

Pika 9

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 3206-0 Z.K. Ferizaj, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 489-16 Z.K. Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt, urdhëro drejtor.

Sabri Murseli – Faleminderit Kryesues, Ky Propozim – Vendim ka të bëjë me “Stacionin e autobusëve” është nxjerrja e shiritit të kyqjeve të autobusëve nga rruga “Cen Dugolli” në “Stacion të autobusëve” është në kërkesë të infrastrukturës edhe kërkesë të palës, sipërfaqe e cila mirret në ballin ipet në vijën anësore që ka më shumë pjesë ballore për autobusa që do të shërbej të ipet pjesa anësore, që është pjesë e komunës d.m.th mirret te balli ipet anash, është pretekst për “Stacion të autobusave”, kemi dy kërkesa të infrastrukturës me vazhduar tutje, është pjesë ideale, kisha dashtë me procesu, faleminderit .

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Drejtor, a dëshiron dikush të diskutoi për këtë pikë tjetër?, nuk ka, atëherë kush është të kaloj për kuvend pika 9-të; 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon për kuvend, vazhdojmë me pikën e 10-të të rendit të ditës.

Pika 10

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrës kadastrale 710-0 Z.K. Bibaj, me sipërfaqe prej 6 m², KEDS-SH.A.d.m.th për trafo, urdhëro drejtor.

Sabri Murseli – Faleminderit Kryesues, ky propozim ka të bëjë me vendosjen e trafos, është për 99 vite në shfrytëzim, e që qiraja është 1.00€ për m² dhe mbas ligjshmërisë nënshkruhet kontrata.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Drejtor, a dëshiron dikush të diskutoi për këtë pikë tjetër?, nuk ka, atëherë kush është të kaloj për kuvend pika 10-të; 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon për kuvend, vazhdojmë me pikën e 11-të të rendit të ditës.

Pika 11

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për aprovimin e kërkesave për blerjen e banesave për të cilat ekziston e drejta e parablerjes, drejtor ketë e këna pas edhe në mbledhjen tjetër të KPF-së, nëse mundesh me na sqaru edhe një herë për këtë pikë të rendit të ditës.

Sabri Murseli – Faleminderit Kryesues, në Vitin 2022 Ministri i Ministrisë për Infrastrukturë ka nxjerr vendim përmes së cilit Ligji për shitjen e banesave nga bartësit e së drejtës banesore përkatësisht shfrytëzuesit e banesave në pronësi shoqërore apo publike për të cilat ekziston e drejta e banimit, siç paraqitet në Ligjin e Nr. 08/L-011 për Plotësim - Ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për shitjen e banesave, cilat ekziston e drejta e banimit Nr.04/L- 247, pra ky propozim ka ardh në kuadër të Ligjit për Shitjen e Banesave dhe ka hy në fuqi 2012 është vazhdu 2014 dhe së fundi është vazhdu 2022 me mundësi që dy herë na lejohet prej ministrit me vendim të veçantë, këtu banesat që realisht po thojna që janë të komunës, por këto janë shitë dhe janë në shfrytëzim simbas kontratave dhe shërbimeve administrative në shfrytëzim të personave, ndodh që të gjitha vendimet

dhe kontratat janë në rregullë, i kam përgatit dosjet dhe kontratat në mënyrë ma të plotë në mënyrë që të kemi në kuvend, e të mos kemi dilema të dokumentacionit, arsyet pse nuk janë përkthyer, ka qenë pagesa e kësteve me kohë ose që ka qenë e pa qartë shfrytëzimi forma, krejt për sa vite është dhanë, kështu që kontratat janë të sakta që kanë qenë në shfrytëzim të përhershëm, që kanë qenë pagesa me këste që kanë argumentu pagesën e kësteve deri në fund, për këtë arsye edhe janë ardhur për kuvend Raporti i Komisionit për Shitjen në Banësavë, kështu që kisha propozu që të vazhdoi tutje, nëse ka diçka ministria, se në komuna janë krye shumë disa raste, na miratojmë bordin e drejtorave, e na besojmë që nuk ka borgje të më tutjeshme, faleminderit .

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Drejtor, a ka qenë ma mirë me qenë si propozim pika e rendit të ditës apo si një raport, ose Aprovimi i Raportit të Komisionit.

Sabri Murseli – Aprovimi i Raportit të komisionit.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Na nuk mundemi me prur vendim as për shitjen e as për blerjen, na mujna me aprovu Raportin në kuvend, e qesim aprovimin e raportit, sot e këna sqaru pak ma mirë këtë pikë që është më e kuptueshme dhe më e arsyeshme, kush është të kaloj për kuvend pika 11- të; 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon për kuvend, vazhdojmë me pikën e 12-të të rendit të ditës.

Pika 12

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesëve të ngastrave kadastrale; 692-4, 694-2, 693-3 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 1178-0 Z.K. Prelez i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt, urdhëro drejtor.

Sabri Murseli – Faleminderit Kryesues, Ky Propozim – Vendim ka të bëjë me Shpalljen Interes i Përgjithshëm për rregullimin e parcelave, realisht është në interes të komunës që rregullohet rruga për kyqje në arra, rrugë kyqe që rregullon parcelat edhe bahet në vi të drejt, kështu që pjesa e rrugës zhvendoset drejt dhe bëhet kyqja e parcelave mbrapa që kufizohet dhe kalon në mënyrë të drejtë, se mu nda parcela edhe në skicë e kështu që propozimi është kjo parcelë, këmbëhet me këtë parcelë tjetër këto kalojnë në emër të komunës komplet dhe kjo tjetra kalon në emër privat, kjo është qasja më e lehtë dhe më e përshtatshme në Prelez të Jerlive, nuk ka interes tjetër veç organizimi dhe rregullimit të dy parcelave.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Drejtor, a dëshiron dikush të diskutoj, jo, kush është të kaloj për kuvend pika 12-të; 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon për kuvend, vazhdojmë me pikën e 13-të të rendit të ditës.

Pika 13

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 963-1 Z.K. Talinoc i Muhaxherëve, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 7-0 Z.K. Muhoc, pronë e Komunës së Ferizajt, urdhëro drejtor.

Sabri Murseli – Faleminderit Kryesues, Ky Propozim – Vendim ka të bëjë me shpallje interes të përgjithshëm të kësaj ngastre kadastrale në Talinoc të Muhagjerëve, sepse me implementimin e rrugës “Qamil Lipovica” me fshati Talinoc i Muhaxherëve që është sjellur në komitet, e kanë gjetur një zgjidhje, e që është më e arsyeshme me shpallje të interesit të përgjithshëm të bëhet këmbimi, kjo është e implemetuar, asfalti është kryer krejt në mes dy fshatrave me sipërfaqe 22 ari e 98 m².

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Drejtor, a dëshiron dikush të diskutoi, jo kush është të kaloj për kuvend pika 13-të; 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon për kuvend, pikën e 14-të e këna kry, vazhdojmë me pikën 15.

Pika 15

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të Zaskokut, lokacioni për ndërtimin e objektit në Fshatin Zaskok, caktohet në parcelën kadastrale 955-0 Z.K. me sipërfaqe prej 5 ari (500 m²), pronë e komunës e cila do të shërbejë për të pame të Komunitetit të Zaskokut, ndërtimi dhe financimi do të bëhet nga banorët e Fshatit Zaskok, urdhëro Drejtor.

Sabri Murseli – Faleminderit Kryesues, me datën 24-25 e kemi pranuar kërkesën prej Fshatit Zaskok për caktimin e një lokacioni për ndërtimin e një objekti të komunitetit, për nevoja të komunitetit aty, në këtë kërkesë është bashkangjitur edhe kërkesa komplet e lagjes, kërkesa ka qenë e banorëve të lagjes 955-0 Z.K. Zaskok me sipërfaqe prej 5 ari (500 m²), kërkesën prej 5 ari e ka paraqitur Mustafë Mahalla, e që shërben vetëm për “Lagjen Mahalla” në Fshatin Zaskok, është pak pjesa e parcelës 955-0 Z.K. me sipërfaqe prej 5 ari (500 m²), e cila caktohet si lokacion për ndërtimin e një objekti për komunitet, e mbas ndërtimit të vendoset trafoja e shërbimet komunale që janë dediku për këtë lokacion, faleminderit .

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Drejtor, a dëshiron dikush të diskutoi, jo kush është të kaloj për kuvend pika 15-të; 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon për kuvend, vazhdojmë me pikën e 16-të.

Pika 16

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Propozim - Vendim për Plotësim - Ndryshimin e Vendimit me Nr. 01.Nr. 2863 të datës 30.11.2005, mes të cilit është ba ndarja – destinimi i ngastrës kadastrale 180-10 Z.K. Talinoc i Jerlive për lapidarin e Dëshmorit “Driton Islami”, kërkesa e familjes ka qenë të bëhet rrethoja komplet 15 ari që në të ardhmën mund të bëhet ndonjë ndryshim, 15 ari bëhet me parkë dhe bahet komplet qysh duhet për lapidarin nga 3 ari në 15.00 ari e 20 m² (1520 m²), urdhëro drejtor.

Sabri Murseli – Faleminderit Kryesues, Kryesues për këtë vendim si sipërfaqe për lapidarin e Dëshmorit të kombit “Driton Islami”, me parkë nga 3 ari në 15.20 ari e 20 m² (1520 m²), d.m.th.

vetëm ajo pjesa e betonit, pjesë e vogël për kyqje, me kërkesë të nipave të tij ka ardhë që të caktohet sipërfaqe brenda rrethojës, rrethoja që shërben si park, lokacion i plotë 15 ari bëhet me park dhe bahet komplet qysh duhet për lapidarin e Dëshmorit "Driton Islami", kjo bëhet brenda rrethojës sa është rrethoja, nuk del jashtë rrethojës, ta kemi të qartë. Rrethoja është në kuadër të PZHK e planifikume dhe duhet me formalizu.

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Drejtor, a dëshiron dikush të diskutoi?

Lulzim Abazi – Faleminderit Kryesues, Këto lloj kërkesa që po na vijnë kështu, po më duket që nuk është në rregull bëhet fjalë për një dëshmor dhe faktikisht prej familjarëve të tij, tash na e dimë që është aty 3 ari, 15 ari apo 5 ari, është mirë paraprakisht me dal me ba matjen nëse veç është kërkesë me ardhë pak më në rregullë dokumentacioni, e tash pse nipat kanë qef, nuk është në rregull kërkesa familjare prej 3 ari 15 ari, nuk është problemi 15 ari, dihet se në atë zonë brenda se sa ari është, prandaj duhet të bëhet matje faktike edhe të dihet sa të ndahet, e kështu që drejtor mos me pasur kurgja afër vetit, nuk e di se çka bahet, e ki për obligim me pru në Komitet, po mos me u paraqit para aktit të kryem e na me dal keq,


Sabri Murseli – Matjet janë kry brenda rrethojës dhe janë sjellë koordinatat e sakta këtu brenda rrethojës, janë kryer në fakt, se për ndryshe nuk ju kisha pru këtu, Faleminderit .

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – Faleminderit Drejtor, kush është të kaloi për kuvend pika 15-të; 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon për kuvend, vazhdojmë me pikën 16-të të ndryshme.


Pika 17

Kryesuesi i KPF-së, Xhavit Zariqi – A ka dikush të diskutoi për pikën të ndryshme, nuk ka, pra e shpalli të mbyllur mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Procesmbajtësja



Zyliha Tafarshiku



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi